

NE JEMI



TË RINJË

# VOTA E GJITHSECILIT KA VLERË TË NJËJTË

ENDRIT (13), FATON (13), ALBERT (13), LEJLA (12), JONA (12), ANISA (13), ALBIONA (14), ELBONA (12),


ARJAN (13)



## Lexues të dashur, në këtë artikull do të mësoni më shumë për procesin zgjedhor dhe për vlerën e votës

A keni menduar ndonjëherë se çfarë vlere ka vota juaj? Pse zgjedhjet janë procesi më i rëndësishëm demokratik? Nga cila moshë kemi të drejtë të marrim pjesë në procesin zgjedhor? Përgjigjet e këtyre pyetjeve, sot i morëm në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ dhe ato do t’i ndajmë me ju. Zgjedhjet janë zemra e demokracisë. Përmes tyre secili qytetar ka të drejtë të shprehë mendimin e vet lirshëm. Duke zgjedhur kështu përfaqësuesit e popullit, të cilët janë deputetët. Siç e dini, Kosova ka rreth 2 milionë banorë, dhe nëse nuk do të ishte procesi i votimit nuk do të kishte mundësi të diskutoheshin shumë çështje shtetërore. Prandaj, e drejta e votimit, të cilën e kanë të gjithë qytetarët pa asnjë dallim, e fuqizon edhe më shumë sistemin demokratik. Vendimmarrja me anë të votimit


e ka lehtësuar shumë jetën tonë. Edhe pse ne ende nuk e kemi mbushur moshën 18 vjeçare, ne kemi marrë vendime të ndryshme me anë të votës. Marrim shembull: zgjedhjen e kryetarit, arkatarit apo sekretarit të klasës. Mendimet e të gjithë nxënësve të klasës janë marrë parasysh. Kjo i bie se përmes zgjedhjeve, fuqinë që e kemi ne, ia japim përkohësisht dikujt tjetër që të na përfaqësojë neve në mënyrën më demokratike. Ne i zgjedhim deputetët, deputetët përfaqësojnë interesat dhe nevojat tona, si dhe ata zgjedhin Presidentin e vendit. Zgjedhjet në Kosovë janë përgjegjësi e çdo qytetari. Secili qytetar duhet të bazohet në mendimin e vet për të votuar, pa u ndikuar nga mendimet e dikujt tjetër. Prandaj, mos harroni se vota juaj mund të bëjë ndryshime të mëdha në qeverisjen e vendit.



Ti vendos, sepse vota jote ka vlerë të madhe



Të lumtur që jetojmë në demokraci



Këta jemi ne




Neve na takon e drejta e fjalës së lirë



Duke qenë gazetarë, ne e dijmë vlerën e demokracisë



Ngado që shkojmë...




Vendi nga dalin ligjet e vendit tonë



Selvija dhe Egzona vizatojnë së bashku

## KUVENDI, E MIRA JONË E PËRBASHKËT

ANISA (12), BLERTA (13), QËNDRESA (11), BLERTA (13), ALBION (12), ALBINA (12), FIORENTINA (12),  
REFIK (12), NEZIR (12), OLTA (13)



Në këto dy vizatime kemi paraqitur rëndësinë që ka Kuvendi i Kosovës. Në të majtë është miratimi i ligjeve, kurse në të djathtë është paraqitur se si këto ligje na ndihmojnë që të gjithë ne të trajtohemi në mënyrë të barabartë

### Kuvendi është një institucion, i cili luan rol shumë të rëndësishëm për secilin qytetar

Të gjithë njerëzit anë e mbanë botës, dëshirojnë që jetën e tyre ta jetojnë në mënyrën më të mirë të mundshme. Të gjithë ne kemi një jetë dhe për këtë meritojmë të jetojmë të lumtur. A thua, a do të mund të jetojmë të lumtur, në qoftë se nuk do të ekzistonin rregullat apo ligjet?

Ne mendojmë se kjo gjë është pothuajse e pamundur, sepse po të mos ekzistonin ligjet, jeta jonë nuk do të ishte kaq e përsosur, siç është me ligje.

Por, kush e bën miratimin e këtyre ligjeve? Miratimin e ligjeve e bën një institucion, i cili njëkohësisht është edhe institucioni më demokratik. Ky institucion është Kuvendi i Kosovës. Kuvendi përkujdeset që secili qytetar të jetojë i barabartë dhe i lirë me qytetarët e tjerë. Këtë e bën duke miratuar ligje, që ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve të vendit. Pasi të miratohen këto ligje, patjetër që duhet të zbatohen nga të gjithë ne, qytetarët e Republikës së Kosovës. Kjo për arsye se, e gjitha kjo është në të mirën tonë. Për shembull, ne duhet t'i bindemi dhe të zbatojmë ligjin për mbrojtjen e ambientit. Ka arsye të shumta se pse duhet ta zbatojmë atë, e disa nga to janë: të kemi një ambient më të pastër, një shëndet më të mirë, por duke mos harruar edhe fuqinë të cilën e ka ligji.

Në një farë mënyre, ne jemi inicues të këtyre ligjeve, sepse fillimisht këto ligje propozohen nga deputetët të cilët ne, populli i kemi zgjedhur. Kuvendi i Kosovës është i përbërë nga 120 deputetë, të cilët janë zëri i popullit. Këta deputetë kanë detyra dhe përgjegjësi të shumta. Disa nga to janë: të zgjedhin Presidentin, të miratojnë buxhetin, të zgjedhin Qeverinë, etj. Përpos këtyre detyrave, Kuvendi ka edhe disa funksione kryesore, që janë: propozimi dhe miratimi i ligjeve, mbikëqyrja e Qeverisë si dhe përfaqësimi i popullit. Kjo pra e bën Kuvendin institucionin më me ndikim në jetën tonë. Ne nuk e paramendojmë jetën tonë pa Kuvendin, sepse Kuvendi na e lehtëson jetën tonë.



Ky artikull është shkruar nga këta nxënës

## SJELLJET E MIRA TË QYTETARËVE

ARLINDA (12), ERBLINA (13), SELVIE (13), LENDRIT (12), ARMEND (14), BLEDAR (13), ALTIN (13),  
EGZONA (12), GENTIANA (14)

**Ne si grup kemi vendosur të shkruajmë për qytetarinë aktive. Prandaj, ju urojmë lexim të mbarë të gjithë juve, lexues të dashur**

Të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejta të barabarta. Ne të gjithë kemi barazi dhe të gjithë mund ta shprehim mendimin tonë. Ne si qytetarë kemi interesa, brenga dhe nevoja të ndryshme, pa marrë parasysh racën, fenë, gjininë, etj. Pikërisht për këtë shkak, ne duhet t'i themi „Ndal“ racizmit. Qytetarët në demokraci kanë shumë të drejta. Disa nga to janë: e drejta e votimit, e shkollimit, e jetesës së lirë, etj.

Tek e drejta e votës, populli duhet të votojë kandidatin që mund t'i bëjë mirë popullit. Pak kohë më parë gratë dhe të varfërit nuk e gëzonin këtë të drejtë. Por, për fat të mirë gjendja ka ndryshuar dhe ne të gjithë e gëzojmë tashmë këtë të drejtë.

Populli duhet të jetë gjithmonë aktiv, në të gjitha projektet që janë të mira dhe të dobishme për qytetarët. Për të pasur të drejtën e pjesëmarrjes në procesin e votimit, duhet të kemi arritur moshën 18 vjeçare.

Tek e drejta e shkollimit, të gjithë nxënësit duhet të mësojnë, pasi që suksesi që kanë arritur jo vetëm që i plotëson interesat dhe nevojat e nxënësve, por edhe të shtetit. Suksesi i nxënësve i nevojitet shtetit, dhe ata me sukseset e tyre mund ta përfaqësojnë shtetin e tyre një ditë. Ne jemi qytetarë të mirë, sepse kemi sjellje dhe respekt ndaj njëri-tjetrit. Nëse ne i respektojmë ligjet dhe të drejtat tona, atëherë ne kemi arritur mirëqenie për të gjithë.



E drejta e shkollimit na takon neve



Ne shkruajmë dhe punojmë së bashku



Të gjithë qytetarët duhet të dalin të votojnë



Ne kemi të drejtë për strehim dhe shtëpi të sigurta



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: info@demos-ti.org  
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Akrashticë“  
Klasa: VII  
Vendi: Vushtrri